

RELACION

Mbi

Raportin e Monitorimi të Zbatimit të Buxhetit për vitin buxhetor 2021

Për vitin 2021, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë administroi dhe menaxhoi fondet buxhetore sipas 12 programeve buxhetore si vijon:

- Planifikim, Menaxhim, Administrim
- Transporti Rrugor
- Transporti Detar
- Transporti Hekurudhor
- Transporti Ajror
- Furnizimi me Uje dhe Kanalizime
- Menaxhimi i Mbetjeve Urbane
- Mbështetje për Energjinë
- Mbështetje për Burimet Natyrore
- Mbështetje për Industrinë
- Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit
- Planifikimi Urban

Në zbatim të ligjit 137/2020 "Për buxhetin e vitit 2021", plani i buxhetit për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë u miratua në vlerën 49.875.338.000 lekë, sipas zërave:

- Shpenzime korrente 4.221.500.000 lekë
- Shpenzime kapitale 45.653.838.000 lekë
nga të cilat:
 - *shpenzime kapitale me financim të brendshëm* 27.434.211.000 lekë
 - *shpenzime kapitale me financim të huaj* 18.219.627.000 lekë

Gjatë vitit 2021, plani i buxhetit për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, pësoi ndryshime në kuadër të rishikimit të buxhetit:

1. me Aktin Normativ nr.26, datë 22.06.2021, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.137/2020 "Për buxhetin e vitit 2021"
 - Shpenzimet korrente, u pakësuan në vlerën 75.600.000 lekë,
 - Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, u shtuan në vlerën 7.300.000.000 lekë,
 - Shpenzimet kapitale me financim të huaj, u pakësuan në vlerën 753.000.000 lekë,
2. me Aktin Normativ nr.34, datë 03.12.2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.137/2020 "Për buxhetin e vitit 2021"
 - Shpenzimet korrente, u shtuan në vlerën 1.364.670.000 lekë,
 - Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, u shtuan në vlerën 7.244.400.000 lekë,
 - Shpenzimet kapitale me financim të huaj, u pakësuan në vlerën 2.891.189.000 lekë
3. Në zbatim të VKM nr.525, datë 01.07.2020 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të Urës së Tapizës dhe caktimin e Autoritetit Rrugor Shqiptar si njësi zbatuese", në buxhetin e vitit 2021, për programin "Transporti Rrugor", Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.4349/1 prot., datë 11.03.2021, miratoi kalimin e fondit buxhetor në vlerën 151,539,896 lekë pa TVSH, nga Fondi i Rindërtimit.
4. Në zbatim të VKM nr.771, datë 15.12.2021 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të godinës së Institutit të Ndërtimit dhe caktimin e Institutit të Ndërtimit si njësi zbatuese", në buxhetin e vitit 2021, për programin "Planifikim, Menaxhim, Administrim" Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.22950/1 prot., datë 28.12.2021, miratoi kalimin e fondit buxhetor në vlerën 13.786.083 lekë pa TVSH, nga Fondi i Rindërtimit.

Plani fillestar dhe plani i rishikuar i buxhetit për vitin 2021 sipas programeve buxhetore, paraqitet si më poshtë:

<i>në mijë lekë</i>			
Kod Programi	Programi	Plani Fillestar	Plani i rishikuar
01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	506.100	540.649
04520	Transporti Rrugor	26.221.055	36.870.924
04540	Transporti Detar	155.000	152.728
04550	Transporti Hekurudhor	2.122.000	1.514.247
04560	Transporti Ajror	140.300	103.640
06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	12.709.511	16.942.036
06220	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	3.714.272	3.423.972
04320	Mbështetje për Energjinë	3.246.000	2.405.411
04430	Mbështetje për Burimet Natyrore	282.000	263.650
04440	Mbështetje për Industrinë	406.000	391.754
04610	Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit	20.000	20.000
06180	Planifikimi Urban	353.100	132.226
	TOTALI	49.875.338	62.761.236

Të dhënat e raportuara mbi planin e buxhetit dhe realizimin faktik përkojnë plotësisht me të dhënat e gjeneruara nga SIFQ lidhur me shpenzimet korrente dhe shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, ndërsa për financimin e huaj MIE nuk ka akses në gjenerimin e të dhënave.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas zërave përbërës të shpenzimeve (në %) paraqitet si më poshtë:

Kod. Prog.	Programi	Shpenzime Korrente (në %)	Shpenzime Kapitale (në %)	
			me Financim të Brendshëm	me Financim të Huaj
01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	97.6	65.6	-
04520	Transporti Rrugor	96.4	99.7	83.7
04540	Transporti Detar	93.2	94.7	-
04550	Transporti Hekurudhor	99.9	66.2	58.8
04560	Transporti Ajror	90.4	99.3	-
06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	93.4	96	85.2
06220	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	99.6	91	97.2
04320	Mbështetje për Energjinë	80.9	95.7	11.2
04430	Mbështetje për Burimet Natyrore	99.1	94.9	-
04440	Mbështetje për Industrinë	97.7	79.6	-
04610	Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit	-	-	0
06180	Planifikimi Urban	93.6	83.5	-

Plani fillestar, plani i rishikuar dhe realizimi faktik (në %) i Shpenzimeve Kapitale me Financim të Brendshëm sipas programeve buxhetore, paraqitet si më poshtë:

në 000 lekë

Kod Programi	Programi	Plani Fillestar i Financimit të Brendshëm	Plani i rishikuar i Financimit të Brendshëm	Realizimi i Financimit të Brendshëm (në %)
01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	13.000	45.978	65.5
04520	Transporti Rrugor	17.812.923	25.764.463	99.7
04540	Transporti Detar	50.000	50.000	94.7
04550	Transporti Hekurudhor	300.000	300.000	66.2
04560	Transporti Ajror	122.000	94.000	99.3
06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	6.508.016	13.449.016	96
06220	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	2.064.272	1.924.972	91
04320	Mbështetje për Energjinë	250.000	250.000	95.7
04430	Mbështetje për Burimet Natyrore	125.000	125.000	94.9
04440	Mbështetje për Industrinë	85.000	58.400	79.6
04610	Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit	-	-	-
06180	Planifikimi Urban	104.000	103.000	83.5
	TOTALI	27.434.211	42.164.829	97.7

Performanca dhe statusi i produkteve kryesore

PROGRAMI “PLANIFIKIM MENAXHIM ADMINISTRIM”

Në këtë program monitorohen dhe menaxhohen fondet buxhetore të miratuara me ligjin vjetor të buxhetit, për realizimin e qëllimit dhe arritjen e objektivave të politikës së programit, për funksionimin dhe forcimin e kapaciteteve administrative të Aparatit të Ministrisë së Infrastruktues dhe Energjisë dhe Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, për zbatimin e të gjitha procedurave të shpronësimit ose të marrjes në përdorim të përkohshëm, për interes publik, të pasurive të personave fizikë ose juridikë privatë; administrimin e fondeve të buxhetit të shtetit për shpronësim, për të gjitha njësitë e pushtetit ekzekutiv në njësitë e qeverisjes qendrore.

Referuar funksionit dhe përgjegjësisë që ka Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, në buxhetin e vitit 2022 ky institucion është përfshirë në programin “Planifikimi Urban”.

Gjatë vitit 2021, në Aparatin e Ministrisë janë realizuar 9 projekt-akte ligjore dhe nënligjore nga 9 të planifikuara vjetore; janë ndërmarrë 15 angazhime auditimi nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm nga të cilat 5 auditime të kombinuara, 6 auditime financiare dhe 4 auditime të përputhshmërisë, nga këto 1 angazhim auditimi është inicuar drejtpërdrejtë nga Ministri për institucionet e varësisë nga 24 të planifikuara. Janë kryer 8 pagesa për kuotizacione ndërkombëtare sipas atyre të planifikuara për MIE.

Shpenzimet korrente

- Paga dhe sigurime shoqërore (*art. 600 dhe 601*), plani buxhetor i rishikuar i vitit 2021 prej 302,9 milion lekë është realizuar në vlerën 298 milion lekë ose 98%.
- Shpenzime operative (*art.602*), plani buxhetor i rishikuar i vitit 2021 prej 119.5 milion lekë është realizuar në vlerën 119.5 milion lekë ose 100%.
- Transferrat korrente të huaja (*art.605*), plani buxhetor i vitit 2021 prej 28 milion lekë është realizuar në vlerën 21.6 milion lekë ose 77%, pagesa të cilat janë realizuar për ICOLD, TCT, Energy community, ITU, OMI, OTIF, UPU, CEPT. Për shkak të mungesës së dokumentacioneve të tyre financiar nuk është kryer pagesa për kontributet e anëtarësisë në organizatën Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë së Rinovueshme (IRENA) si dhe në Komisionin Ndërkombëtar të Digave të Mëdha (ICOLD).
- Transferrat për Buxhetin Familjar dhe Individual (*art.606*), plani buxhetor i rishikuar i vitit 2021 prej 44.1 milion lekë është realizuar në vlerën 43.7 milion lekë ose 99%. Sqarojmë se për shkak të numrit të lartë të personave që kanë depozituar dokumentacionet përkatëse janë likuiduar 981 praktika për vitin 2020 dhe 53 praktika për vitin 2021. Fondi i mbetur në vlerën prej 429 mijë lekë nuk është rimbursuar për shkak të gabimeve në dokumentacion, konkretisht në numrat e llogarive bankare të personave.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm

Plani buxhetor i rishikuar për vitin 2021, për investimet me financim të brendshëm, për këtë program është në vlerën 45.9 milion lekë.

Sipas projekteve ai paraqitet:

- “Blerje pajisje për zyrat”, është planifikuar në vlerën 736 mijë lekë si nevojë e Agjencisë Shtetërore të Shpronësimeve dhe realizimi financiar është në masën 100%.

- “Blerje pajisje elektrike pc, fotokopje etj” është planifikuar në vlerën 1.2 milion lekë dhe realizimi financiar është në masën 88%.
- “Rikonstruksion i godinës së ish MZHU” është planifikuar në vlerën 6.9 milion lekë dhe realizimi financiar është në masën 100%.
- “Kolaudim për Rikonstruksionin e godinës ish MZHU” është planifikuar në vlerën 120 mijë lekë dhe realizimi financiar është në masën 100%.
- “Blerje pajisje zyre” është planifikuar në vlerën 120 mijë lekë dhe nuk është realizuar.
- “Sistemi i sinjalizimit të fonisë, projektim, ndricimit në sallën e mbledhjeve” është planifikuar në vlerën 91.5 mijë lekë dhe nuk është realizuar.
- “Blerje pajisje elektronike” është planifikuar në vlerën 2.1 milion lekë dhe realizimi financiar është në masën 100%.
- “Shpronësime për Ndërtimin Rajonal Memorial, Fier” është planifikuar në vlerën 20.8 milion lekë dhe realizimi financiar është në masën 92% pasi është në proces likuidimi në varësi të dokumentacionit të depozituar.
- “Rikonstruksion i godinës së Institutit të Ndërtimit” në zbatim të VKM nr.771, datë 15.12.2021 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të godinës së Institutit të Ndërtimit dhe caktimin e Institutit të Ndërtimit si njësi zbatuese” në vlerën 13.786.083 lekë do të kalojë në vitin 2022 sipas procedurave me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Sqarojmë se në zbatim të udhëzimit plotësues nr.1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit për vitin 2022”, pika 13, d, fondi prej 13.786.083 lekë për projektin “Rikonstruksion i godinës së Institutit të Ndërtimit” do të trashëgohet për vitin buxhetor 2022.

PROGRAMI “TRANSPORTI RRUGOR”

Bazuar në objektivin e përgjithshëm të Strategjisë Sektoriale të Transportit dhe Planit të Veprimit, programi i transportit rrugor synon:

- Të zhvillojë më tej sistemin kombëtar të transportit;
- Të përmirësojë ndjeshëm qëndrueshmërinë, ndërlidhjen, ndërveprimin dhe integrimin e tij më gjerë, me sistemin ndërkombëtar dhe evropian të transportit dhe rajonin;
- Programi synon mbulimin me financim dhe zgjerimin, rritjen e standardeve dhe mirëmbajtjen e rrjetit kombëtar të rrugëve, me synim krijimin e një transporti të qëndrueshëm;

Gjatë vitit 2021, buxheti për programin "Transporti Rrugor", pësoi ndryshime në kuadër të rishikimit të buxhetit dhe Aktet Normative të miratuara janë si vijon :

Me Aktin Normativ nr.26, datë 22.06.2021, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.137/2020 "Për buxhetin e vitit 2021"

- Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, u shtuan në vlerën 4,800,000,000 lekë,
- Shpenzimet kapitale me financim të huaj, u shtuan në vlerën 753,000,000 lekë,

Me Aktin Normativ nr.34, datë 03.12.2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.137/2020 "Për buxhetin e vitit 2021"

- Shpenzimet korrente, u shtuan në vlerën 1,400,000,000 lekë
- Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, u shtuan në vlerën 3,000,000,000 lekë
- Shpenzimet kapitale me financim të huaj, u shtuan në vlerën 545,000,000 lekë

Shpenzimet korrente

- Fondi i pagave dhe sigurime shoqërore (art. 600 dhe 601), plani 164,745,175 lekë dhe realizimi financiar 160,706,884 lekë ose në masën 98%,
- Fondi i shpenzimeve operative (art.602), plani 2,735,218,825 lekë dhe realizimi financiar 2,635,386,521 lekë ose në masën 96%,
- Fondi për transferta e buxhete familjare (art.606), plani 466,500 lekë dhe realizimi financiar 217,500 lekë ose në masën 47 %.

Me fondet buxhetore shtesë të akorduara me Aktin Normativ për financimin e kontratave të mirëmbajtjes, u likuiduan të gjithë detyrimet e prapambetura të krijuara deri 13.12.2021 dhe u plotësuan nevojat që kishin për fonde buxhetore të gjithë kontratat e mirëmbajtjes rrugore deri në datën 31.12.2021.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm

Në buxhetin e shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm, janë financuar projektet e Infrastrukturës rrugore, me njësi shpenzuese të përfshira në këtë program, Aparati i MIE, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Instituti i Transportit, njësitë e qeverisjes vendore Kuçovë, Tepelenë, Berat, Vlorë, Fier.

Për Aparatin e MIE, gjatë vitit 2021, ka vazhduar implementimi, zbatimi dhe financimi i kontratave koncesionare/PPP, sipas kësteve të miratuara në Modelet Financiare përkatëse, së bashku edhe me inxhinierin e pavarur, për:

- "Ndërtim, operim, mirëmbajtje rruga e Abrit",
- "Ndërtim operim, mirëmbajtje rruga Milot–Morinë",
- "Ndërtim, operim, mirëmbajtje rruga Orikum-Dukat, Ura e Shën-Elizës, Porti i Jahteve".

Gjithashtu, MIE në nëntor të vitit 2021 përfundoi procedurat e prokurimit dhe të lidhjes së kontratës së projektit të infrastruktures rrugore, "Ndërtim Tuneli i Llogarasë", për të cilin financimi filloi në fund të muajit dhjetor të vitit 2021.

Për Autoritetin Rrugor Shqiptar, me buxhetin e vitit 2021, u financuan totalisht 12 projekte zbatimi dhe rikonstruksione:

- 1- Ndërtim rruga Kardhiq – Delvinë, Loti 4,
- 2- Ndërtim rruga Kardhiq – Delvinë, Loti 5,
- 3- Ndërtim rruga Kardhiq – Delvinë, Loti 6,

- 4- Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (seg. Kthesa Saukut - Bregu i lumit Loti 3),
- 5- Ndërtim rruga Porto Romano Durrës, Loti 3,
- 6- Stabilizim i rrëshqitjeve në segmentin rrugor Milot - Rrëshen, rruga e vjetër,
- 7- Stabilizimi i qëndrueshmërisë të trupit të rrugës në aksin rrugor Vlorë – Orikum (zona Jonufër – Nimfa),
- 8- Ndërtim tombino dhe kanali në aksin rrugor Tiranë - Elbasan (aksi i vjetër) dhe ndërtim tombino në aksin rrugor Uzina traktori – Lanabregas,
- 9- Emergjencë Rrëshqitja e Borshit,
- 10- Ndërtim i Urës së Zemblakut,
- 11- Rikonstruksion i Urës së Dragotit,
- 12- Rikonstruksion i Urës së Leklit.

U financuan totalisht 4 projekte të sinjalistikës dhe siguri rrugore:

- 1 - Punime ndërtimi për eliminimin e pikave të zeza në rrugë (Siguria rrugore);
- 2 - Përmirësim i sinjalistikës horizontale në akset dhe segmentet rrugore të Rajonit Verior;
- 3 - Përmirësim i sinjalistikës horizontale në akset dhe segmentet rrugore të Rajonit Jugor;
- 4- Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale / horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Jugor Loti 3, vazhdimi.

U financuan totalisht 2 projekte studim projektme:

- 1- Studim projektim rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të Unazës së madhe Tiranë nga sheshi Shqiponja-Bulevardi i ri;
- 2 - Studim projektim rikualifikim i Unazës lindore për lotet 4,5,6.

U financuan 3 projekte supervizione punimesh:

- 1- Supervizion punimesh ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tirane, pjesa verilindore (seg. Kthesa Saukut-Bregu i Lumit) Loti 3;
- 2- Supervizion punimesh Vendorsja e mbikalimeve në aksin rrugor Thumanë - Milot dhe Kukës – Morinë;
- 3- Supervizion punimesh Ndërtim By Pass Tepelenë, Loti 1.

U financuan totalisht 3 projekte investimi:

- 1- Përmirësim i dhomës së serverave të ARRSH;
- 2- Blerje pajisje kompiuterike për ARRSH;
- 3- Sistem kondicionimi stacioner për pjesën perëndimore të ARRSH-se (Blerje dhe instalim kondicionere stacioner).

Realizimi sipas produkteve:

Grupi i produktit "Ndërtim Rruge", i shprehur në sasi (km) për 12 mujorin e vitit 2021, është parashikuar 42.07 km dhe është realizuar 42.05 km, kurse shpenzimet faktike për këtë produkt janë planifikuar në vlerën 16,093,328,000 lekë dhe është realizuar 16,067,816,000 lekë ose 99.8 % e planit.

Emertimi	Planifikuar/km	Financuar/km	% e Realizimit Sasior
A2, me standartet e reja	1.49	1.49	100
A, e modifikuar	2.88	2.88	100
A2	4.46	4.46	100
B1'	5.12	5.12	100
C2	28.12	28.10	100

Grupi i produktit "Rikonstruksion Rruge", i shprehur në sasi (km) për vitin 2021, është planifikuar 12,086,000 lekë dhe është realizuar 12,086,000 lekë ose 100 % e planit.

Ndërtim rruge tip A me katër korsi (2x2) sipas Standarteve të reja

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produkti janë në vlerën 4,460,246,000 lekë ose 100% e buxhetit të planifikuar dhe në sasi 1.49 km ose 100 %. Në këtë grup përshihen projektet :

- Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja Loti 1, Loti 2, Loti 3,
- Ndërtim rruga mbikalimi TEG dhe rrugët lidhëse të tij;
- Ndërtim i Unazës së Jashtme Tiranë, Loti 4, Loti 5, Loti 6, Loti 7;
- Plotësimi i punimeve dhe rrugët lidhëse në Unazën lindore, Loti 2;
- Plotësimi, rakordimi dhe vazhdimi i punimeve Sheshi Shqiponja - Lumi i Tiranës, Loti 1 dhe QMT;
- Ndërtim i segmentit rrugor Sheshi Shqiponja - Bulevardi i ri -Shkozë, Urat mbi lumin Tirana;
- Ndërtim i segmentit rrugor Sheshi Shqiponja- Bulevardi i ri, Loti 2;
- Ndërtim rruga mbikalimi Teg dhe rrugët lidhëse të tij;
- Studim Projektim mbikalimi TEG;
- Studim-projektim, rishikim i projektit për segmentin rrugor të vazhimit të unazës së madhe Tiranë nga sheshi Shqiponja - Bulevardi i ri,

Ndërtim rruge tip A2' 2x2 me trotuare dhe ndriçim

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerën 2,688,976,000 lekë (16.7 % ndaj planit të përgjithshëm vjetor (Grupi i produktit "Ndërtim Rruge) dhe në sasi 4.46 km. Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produkti është 2,688,941,000 lekë ose 100 % e buxhetit të planifikuar dhe në km, janë realizuar 4.46 km ose 100 % e sasisë së planifikuar.

Në këtë produkt janë përfshirë kryesisht tip rruge me katër korsi dhe gjërësi që varion nga 24-25 m, me disa projekte të rëndësishëm, si:

- Përfundim i punimeve të mbetura dhe plotësimi me rrugë dytësore nyja e Milotit,
- Ndërtim i unazës së jashtme Tiranë pjesa verilindore (seg Kth Saukut-Bregu i lumit) Loti 2, 3,
- Rikualifikim i akseve rrugore Unaza Lindore Loti 2, Loti 3,
- Ndërtim rruga By Pass Perëndimor Shkodër, Loti 1 + shtesë punimesh dhe Loti 2.

Ndërtim rruge tip B1' me dy korsi

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 4,139,781,000 lekë (25.7 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit "Ndërtim Rruge) dhe në sasi 5.12 km. Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit është 4,139,777,000 lekë ose 100 % e buxhetit të planifikuar dhe në km janë realizuar 5.12 km ose 100 % e sasisë së planifikuar. Në këtë produkt janë përfshirë kryesisht tip rruge me dy korsi dhe gjërësi që varion nga 10-17 m, duke përmendur disa objekte të rëndësishme, në të cilat punohet me ritme të parashikuara, si projekti "Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë Loti 4+ shtesë punimesh, Loti 5+ shtesë punimesh, Loti 6+ shtesë punimesh, Loti 7 dhe Loti 8.

Ndërtim rruge tip C2 me dy korsi

Për tipin e rrugës C2, janë planifikuar fonde në vlerën 4,114,350,000 lekë ose 25.5 % ndaj planit vjetor (grupi i produktit "Ndërtim Rruge) dhe në sasi 28.12 km. Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës C2 është në vlerën 4,088,896,000 lekë ose 99.4 % e buxhetit të planifikuar dhe në sasi 28.10 km ose 99.4 % e sasisë së planifikuar. Janë përfshirë kryesisht tip rruge C2 me dy korsi dhe gjërësi që varion nga 7.5-10 m dhe po punohet normalisht në projektet rrugore që janë në proces:

- Ndërtim By Pass Tepelenë Loti 1, shtesë punimesh;
- Ndërtim rruga Korçë – Ersekë, Loti 2 (pjesa e parë);
- Ndërtim rruga Palasë – Dhërmi;
- Rikonstruksion i rrugës Dukaj - Sinanaj, Tepelenë;
- Ndërtim i rrugës, lidhja e Autostradës Milot - Morinë me Aeroportin e Kukësit;
- Ndërtim i rrugës së Fush - Bardhës, lidhja me rrugën Kardhiq – Delvinë;
- Ndërtimi i rrugës së fshatit Senicë dhe lidhja me rrugën Kardhiq – Delvinë;
- Ndërtim i lidhjes së rrugës së Oroshit me rrugën e Kombit;
- Përfundimi i punimeve në segmentet rrugore Ura e Kranesë Qafë Botë, Ura e Kranesë Ura e Gajdarit dhe përmirësimi i segmentit rrugor Shijan Ura e Gajdarit,
- Rehabilitim dhe masa inxhinierike rruga e Spillesë,
- Stabilizim i rrëshqitjeve në segmentin rrugor Milot - Rrëshen, rruga e vjetër,
- Ndërtim tombino dhe kanali në aksin rrugor Tiranë - Elbasan (aksi i vjetër) dhe ndërtim tombino në aksin rrugor Uzina traktori – Lanabregas.

Ndërtim rruge A e modifikuar

Ky tip rruge përfaqëson një aks rrugor autostradë me katër vija kalimi 4 x 3.75 dhe me dy bankina të asfaltuara me gjerësi 2 x 3 m si dhe dy bankina të paasfaltuara me gjerësi 2 x 1.5 m, së bashku dhe me trafik ndarësen e mesit (New Jersey) gjerësia e trupit të rrugës është 28 m. Për tipin e rrugës A e modifikuar janë planifikuar fonde në vlerën 653,555,000 lekë ose 4% ndaj planit vjetor (Grupi i produktit "Ndërtim Rruge" dhe në sasi 2.88 km. Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës A e modifikuar është në vlerën 653,555,000 lekë ose 100% e buxhetit të planifikuar. Ky zë është realizuar në sasinë 2.88 km ose 100 % e sasisë së planifikuar, në projektet:

- Ndërtim rruga Porto Romano Durrës, Loti 3,
- Ndërtim rruga Porto Romano Durrës, Loti 3, vazhdimi.

Sinjalistikë dhe Siguri Rrugore

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 670,042,000 lekë (100 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit Sinjalistikë rrugore) dhe në sasi 1,237.4 km. Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit është 670,042,000 lekë ose 100 % ndaj planit vjetor dhe në km janë realizuar 1,237.4 km, ku përfshihen projektet:

- Punime ndërtimi për eleminimin e pikave të zeza në rrugë (bashkëfinancim IPA 2013, Siguria rrugore);
- Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Verior Loti 3, vazhdimi;
- Përmirësim i sinjalistikës horizontale në akset dhe segmentet rrugore të Rajonit Verior;
- Përmirësim i sinjalistikës horizontale në akset dhe segmentet rrugore të Rajonit Qëndror;
- Përmirësim i sinjalistikës horizontale në akset dhe segmentet rrugore të Rajonit Jugor.

Ura dhe Emergjencia.

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 351,337,000 lekë (100 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit ndërtim urash) dhe në sasi 0.25 km. Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit është 313,488,000 lekë ose 89% e planit dhe janë realizuar 0.17 km. Në këtë zë janë përfshirë dhe fondet e akorduara për ARRSH-në nga fondi i rindërtimit në vlerën 151,539,896 lekë për projektin "Rindërtimi i Urës së Tapizës" të dëmtuar nga tërmeti, si vijon:

- Rindërtim i Urës së Tapizës;
- Ndërtim i Urës së Zemblakut;
- Emergjence Rrëshqitja e Borshit;
- Rikonstruksion i Urës së Leklit;
- Rikonstruksion i Urës së Vorës;
- Emergjence Rikonstruksion i Urës së Kirit;
- Emergjencë mbrojtje lumore Ura e Drojës;
- Supervizion punimesh Ndërtim i Urës së Zemblakut, Urës së Kaludhit.

Grupi i shpenzimeve për Shpronësime, vendime gjyqësore, TVSH dhe Kosto lokale, i detajuar paraqitet si vijon :

	PLANIFIKUAR	FINANCUAR	
- Vendime gjyqësore	420,000,000 lekë	407,578,663 lekë	ose 97%
- Shpronësime	706,773,876 lekë	685,697,003 lekë	ose 97%,
- TVSH dhe Kosto Lokale	1,958,792,438 lekë	1,953,550,571 lekë	ose 99,7%

Shpenzimet kapitale me financim të huaj

Shpenzimet kapitale me financim të huaj, plani vjetor në vlerën 8,206,132,000 lekë, është realizuar në vlerën 6,881,127,000 lekë ose 84%. Me Aktet Normative të miratuara gjatë vitit 2021, plani i buxhetit për zërin e financimit të huaj, u shtua në vlerën 1,298,000,000 lekë, për financimin e projekteve të huaja të cilat kishin realizim më tepër se plani i miratuar, për:

- Ndërtim By pass i Vlorës,
- Ndërtim By pass i Fierit,
- Projekti i Mirëmbajtjes së Bankës Botërore,
- Ndërtim rruga Qukës – Qafë Pllocë.

Në vlera sasiore, për zërat ndërtim rrugësh Kategoria B, C dhe Kategori të ndryshme (Mirëmbajtje), realizimin e produkteve dhe të shpenzimeve buxhetore për vitin 2021, paraqitet:

Emërtimi	Planifikuar/km	Financuar/km	% e Realizimit Sasior
- Ndërtim Tipi i Rrugës B	17	14	82
- Ndërtim Tipi i Rrugës C	16	13	81
- Ndërtim Rrugë Tip kategori të ndryshme	1333	1333	100

PROGRAMI “TRANSPORTI DETAR”

Në këtë program buxhetor Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të ketë prioritet vazhdimësinë e kryerjes së investimeve prioritare për funksionimin me kapacitet të plotë të porteve dhe përmirësimin e infrastrukturës portuale. Rritja e investimeve do të shërbejë në zhvillimin e Shqipërisë, nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës, kapaciteteve njerëzore, sigurisë dhe sistemit të menaxhimit në porte.

Gjatë kësaj periudhe, në zërin e shpenzimeve korrente janë realizuar fondet për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative si dhe fondi i veçantë për Drejtorinë e Përgjithshme Detare.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm

Sipas projekteve ai paraqitet :

- “Konservimi i Ndërmarrjes së Kontrollit të Shfrytëzimit të Mjeteve Ujore Vau i Dejës” është planifikuar në vlerën 3.1 milion lekë dhe është realizuar për periudhën 12-mujore në masën 100%, për shkak se me keto fonde paguhen pagat dhe sigurimet shoqërore për punonjësit e kësaj ndërmarrje.
- “Blerje kompjutera, printera, fotokopje për DPD dhe Kapiteneritë” është planifikuar në vlerën 7.4 milion lekë dhe realizimi financiar është në masën 100%.
- “Blerje pajisje navigacionale për Kapiteneritë Durrës, Vlorë, Shëngjin, Sarandë” është planifikuar në vlerën 730 mijë lekë dhe realizimi financiar është 586 mijë lekë ose në masën 80%.
- “Rikonstruksion i godinës së DPD” është planifikuar në vlerën 27 milion lekë dhe realizimi financiar është në masën 100%.

- “Rikonstrukcion i kalatës së RORO” është planifikuar në vlerën 6.2 milion lekë dhe realizimi financiar është në masën 100%.
- Kolaudim "Rikonstrukcion i godinës së DPD" është planifikuar në vlerën 55 mijë lekë dhe realizimi financiar është në masën 100%.
- Mbikqyrje punimesh "Rikonstrukcion i Godinës së DPD" është planifikuar në vlerën 674 mijë lekë dhe realizimi financiar është në masën 100%.
- “TVSH për projektin “Asistencë-teknike për monitorimin, komunikimi i kontratës sektoriale” është planifikuar në vlerën 600 mijë lekë dhe realizimi financiar është në masën 70%.
- “TVSH për projektin e rehabilitimit të kalatës së Portit Vlorë” është planifikuar në vlerën 1.8 milion lekë dhe realizimi financiar është në masën 100%.
- “Vazhdimi i sinjalit satelitor LRIT” është planifikuar në vlerën 2.3 milion lekë por nuk u realizua pasi fondi nuk u arrit të prokurohej brenda vitit 2021.

Në zbatim të Aktit Normativ nr.34, datë 03.12.2021, shpenzimet kapitale me financim të huaj u shtuan në vlerën 1.000.000 lekë për projektet “Eco Portil” dhe “South-Adriatic Connectivity Governance (Sagov)”.

Referuar të dhënave mbi realizimin faktik të shpenzimeve kapitale me financim të huaj nga MFE rezulton:

- Për projektin “South-Adriatic Connectivity Governance (Sagov)” është planifikuar në vlerën 500.000 lekë dhe realizimi financiar është në masën 129%. Projekti përfundoi në vitin 2021.
- Për projektin “Eco Portil” është planifikuar në vlerën 500.000 lekë dhe realizimi financiar është në masën 351%. Projekti përfundoi në vitin 2021.

PROGRAMI “TRANSPORTI HEKURUDHOR”

Prioriteti kryesor në fushën e transportit hekurudhor ka qenë dhe mbetet “Reformimi i sektorit hekurudhor për të krijuar një treg të hapur për publikun dhe investitorët privatë”.

Në vijim të kësaj politike janë vendosur objektivat:

- Miratimi akteve ligjore:
 1. Ligji nr.88/2021, datë 1.7.2021 “Për krijimin e Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore”.
 2. Ligji nr.89/2021, datë 1.7.2021 “Për krijimin e Autoritetit Rregullator Hekurudhor”.
 3. Ligji nr.90/2021, datë 1.7.2021 “Për ndarjen e shoqërisë “Hekurudha shqiptare” sh.a”
 4. Ligj nr.91/2021, datë 1.7.2021 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore dhe Detare.
- Kompletimi i gjithë sistemit hekurudhor me studime paraprake, studime fizibiliteti dhe projekt zbatim për ndërtim dhe rikonstrukcion.

- Ruajtja e gjendjes ekzistuese të linjave hekurudhore nëpërmjet realizimit të investimeve në infrastrukturë.

Shpenzimet Korrente

Në këtë program buxhetor janë përfshirë shpenzime për funksionimin e administratës së Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor, në të cilat përfshihen pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe mallra dhe shërbime, për mbarëvajtjen e funksionimit të kësaj strukture si dhe subvencioni në mbështetje të hekurudhës për Hekurudha Shqiptare sh.a.

Realizimi i shpenzimeve korrente sipas klasifikimit ekonomik, paraqitet si më poshtë:

- Fondi i pagave për (art.600), plani prej 9.600 mijë lekë është realizuar 9.504 mijë lekë, ose në masën 99 %.
- Fondi i sigurimeve shoqërore (art.601), plani prej 1.600 mijë lekë është realizuar 1.590 mijë lekë, ose në masën 99.4 %.
- Fondi i shpenzimeve operative (art.602), plani prej 2.930 mijë lekë është realizuar 2.790 mijë lekë, ose në masën 95.2 %.
- Subvencioni për DPH (art.603), plani prej 9.600 mijë lekë është realizuar 9.504 mijë lekë, ose në masën 99 %.

Shpenzimet Kapitale me financim të brendshëm

Realizimi për vitin 2021 sipas produkteve paraqitet si më poshtë:

- Produkti “Sistem Hekurudhor i reformuar”, ku përfshihet subvencioni për mbështetjen e hekurudhës, janë planifikuar 400 milion lekë dhe janë realizuar 400 milion ose 100%.
- Produkti “Inspektime të kryera në linjat dhe mjetet hekurudhore” janë planifikuar 14,2 milion lekë dhe janë realizuar 14 milion lekë ose 98 %
- Produkti “Përmirësimi i infrastrukturës hekurudhore” janë planifikuar në vlerën 104,6 milion lekë dhe janë realizuar 51,2 milion lekë ose 49%.
- Për projektin “Blerje traversa druri” janë planifikuar në vlerën 36,045,734 lekë dhe janë realizuar 5,074,345 lekë ose 14.08%.

Mosrealizimi ka ardhur si pasojë e mospërbushjes së detyrime kontraktuale nga kontraktori, të kontratës së lidhur me datë 23.06.2021 me nr. 53/5 prot, e cila ka qënë për ndjekje dhe zbatim nga NJBMI. Nga HSH është financuar vetëm një faturë situacioni pjesor për atë sasi malli të dorëzuar pranë NJBMI.

- Për projektin “Rikonstruksion i linjës hekurudhore Shkozet – Kavajë” janë planifikuar në vlerën vlerën 9,107,819 lekë dhe janë realizuar 9,101,311 lekë ose 99.93%.
- Për projektin “Rikonstruksion i linjës Kavajë - Rrogozhinë” janë planifikuar në vlerën 6 milion lekë dhe nuk është realizuar.

Mosrealizimi ka ardhur si pasojë e anulimit të procedurës së propkurimit si pasojë e ankesave dhe vendimi të marrë nga KPP.

- Për projektin “Rikonstruksion i linjës hekurudhore Milot – Lezhë” janë planifikuara në vlerën në vlerën 9,109,402 lekë dhe janë realizuar 5,560,120 lekë ose 61.04%.

Mosrealizimi ka ardhur si pasojë e përfundimit të kontratës së lidhur me datë 22.07.2021 me nr.56/5 prot jashtë afateve të përcaktuara dhe konkretisht ka përfunduar në datën 25.01.2022 sipas njoftimit të përfundimit të punimeve. Kontrata ka qenë në ndjekje nga NJBMI. Diferenca transferohet në vitin buxhetor 2022.

- Për projektin “Rikonstruksion i linjës hekurudhore Budull – Gjormë” janë të planifikuara në vlerën 9,958,895 lekë dhe janë realizuar 9,932,073 lekë ose 100%.
- Për projektin “Riparim vepra arti” janë të planifikuara në vlerën 14.000.000 lekë dhe janë realizuar 2,803,800 lekë ose 20.03%.

Mosrealizimi ka ardhur si pasojë e pezullimit të punimeve të kontratës së lidhur me datë 11.11.2021 me nr. 74/5, për arsye madhore të ngritjes së nivelit të ujit dhe është shtyrë me kontratë shtesë të datës 24.12.2021 me nr.74/26 prot, deri në 01.02.2022. Kontrata ka qenë në ndjekje nga NJBMI. Diferenca transferohet në vitin buxhetor 2022.

- Për projektin “Punime nga vetë hekurudha” janë planifikuar në vlerën 5,000,000 lekë dhe janë realizuar 3,269,101 lekë ose 65.38%.

Mosrealizimi ka ardhur si pasojë e mungesës së karburantit për kryerjen e punimeve gjatë muajit nëntor e fillimin e dhjetorit 2021, pasi nuk ka patur karburant HSH.

- Për projektin “Punime për mbrojtjen e linjës” janë të planifikuara në vlerën 4,263,406 lekë dhe janë realizuar 4,261,332 lekë ose 100%.
- Për projektin “Blerje traversa betoni” janë të planifikuara në vlerën 11,159,544 lekë dhe janë realizuar 11,159,544 lekë ose 100%.
- Për produktin “Rritja e disponibilitetit të mjeteve lëvizëse” janë të planifikuara në vlerën 20,894 mije lekë dhe realizuar 16,117 mijw lekë ose 77.1% dhe e ndarë sipas projekteve:
- Projekti “Blerje pjesë këmbimi dhe agregate për lokomotiva dhe vagonë” është rialokuar me Akt Normativ.
- Për projektin “Rinovim agregat për lokomotiva” janë të planifikuara në vlerën në vlerën 8,278,800 lekë dhe janë realizuar 8,268,000 lekë ose 100%.
- Për projektin “Rikonstruksion i magazinave të NJSHML” janë të planifikuara në vlerën 7,021,758 lekë dhe janë realizuar 7,005,071 lekë ose 100%.
- Për projektin “Blerje aksesore hekurudhorë” janë të planifikuara në vlerën 4,750,000 lekë dhe ky projekt nuk është realizuar.

- Për projektin “Paisje zyre per DP Hekurudhave” janë të planifikuara në vlerën 424.800 lekë dhe janë realizuar 424.800 lekë ose 100%.
- Për projektin “Paisje informatike per DP Hekurudhave” janë të planifikuara në vlerën 418.800 lekë dhe janë realizuar 418.800 lekë ose 100%.
- Për produktin “Studime dhe projektme” janë të planifikuara në vlerën 974,461 mijë lekë dhe janë realizuar 602,143 mijë lekë, të ndarë:
 - Për pagesën e TVSH-së të objektit “Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës – Tiranë dhe ndërtimin e linjës së re hekurudhore për në aeroportin e Rinasit” janë planifikuar 95,286, 629 lekë dhe janë realizuar 95,286,629 lekë ose 100%.
 - Për pagesën e TVSH-së së objektit “Hartimi i Projektit të detajuar Inxhinierik për Rehabilitimin e linjës hekurudhore "Vorë - Hani i Hotit (kufi me Malin e Zi)” janë planifikuar 14,050,880 lekë dhe janë realizuar 14,050,879 lekë ose 100%.
 - Për pagesën e TVSH-së së objektit “Supervizioni i punimeve "Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës – Tiranë dhe ndërtimin e linjës së re hekurudhore për në aeroportin e Rinasit" janë planifikuar 20,000,000 lekë dhe janë realizuar 9,766,383 lekë gati 48.83%.
 - Për pagesën e TVSh-së së objektit “Hartimi i Projektit të detajuar Inxhinierik për Rehabilitimin e linjës hekurudhore Durrës – Rrogozhinë” janë planifikuar 14,050,000 lekë dhe janë realizuar 9,329,210 lekë ose 66.4%.
 - Për pagesën e TVSh-së së objektit “IFRS - Standartizimi Ndërkombetar i Raportimit Financiar në Hekurudhat Shqiptare” janë planifikuar 3,660,000 lekë dhe janë realizuar 1,097,843 lekë ose 30%.
 - TVSH Promovimi i Intermodalitetit dhe Rilidhja Hekurudhore në Rajonin Adriatik-Jon janë planifikuar 102.000 lekë dhe janë realizuar 102.000 lekë ose 100%.
 - TVSH Studim I Prefisibilitetit per lidhjen hekurudhore Pogradec- Greqi [Kristalopigy] janë planifikuar 1.720.000 lekë dhe janë realizuar 1.720.000 lekë ose 100%.

Mosrealizimet e likuidimeve të vlerave të TVH-ve kanë ardhur si pasojë e mosparaqitjes së faturave të pagesës nga subjektet e kontraktuara.

Shpenzimet Kapitale me Financim të Huaj

Gjatë vitit 2021 ka vazhduar financimi dhe zbatimi i projekteve me financim të huaj:

- Supervizioni i punimeve "Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës - Tiranë dhe ndërtimin e linjës së re hekurudhore për në aeroportin e Rinasit", është planifikuar në vlerën 25.000.000 lekë, i cili nuk është realizuar. Është lidhur kontrata në 16.02.2021 dhe vazhdon zbatimi i kontratës.
- Hartimi i projektit të detajuar të linjës hekurudhore terminali i transportit publik - stacioni i trenit Tiranë (4km) si zgjatim i linjës hekurudhore Durrës – Tiranë, është planifikuar në vlerën 12.840.000 lekë, i cili nuk është realizuar. Është hartuar draft kontrata, proces negociimi me BERZH dhe konsulentin.

- Plani i Menaxhimit të Aseteve dhe Metodologjia e Tarifimit në Hekurudhat Shqiptare, është planifikuar në vlerën 2.309.000 lekë, i cili nuk është realizuar. Vazhdon puna për zbatimin e kontratës. Konsulenti ende nuk ka prezantuar asnjë faturë edhe pse plani i punës është në përputhje me kontratën. Realizimi fizikisht është mbi 30%.
- Hartimi i Projektit të detajuar Inxhinierik për Rehabilitimin e linjës hekurudhore "Vorë - Hani i Hotit (kufi me Malin e Zi)", është planifikuar në vlerën 19.000.000 lekë, i cili nuk është realizuar. Vazhdon disbursimi në varësi të faturimit të konsulentit pranë donatorëve të huaj. Konsulenti ka përfunduar 100% paketën e projektit të detajuar inxhinierik, studimin mjedisor social, konsultime me publikun. Projekti është aplikuar për grant investimi në WBIF-EBRD.
- Promovimi i Intermodalitetit dhe Rilidhja Hekurudhore në Rajonin Adriatik-Jon, është planifikuar në vlerën 710.000 lekë dhe është realizuar në masën 100%.
- Studim i Prefisibilitetit për lidhjen hekurudhore Pogradec - Greqi [Kristalopigy], është planifikuar në vlerën 8.600.000 lekë dhe është realizuar në masën 10%.
- Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës - Termali i pasagjerëve Tiranë dhe ndërtimi i linjës hekurudhore Tiranë - Rinas 1 (grant) , është planifikuar në vlerën 337,351,587 lekë i cili nuk është realizuar. Punimet kanë nisur në terren me aktivitetet e para. Ndërkohë HSH dhe MIE janë duke përfunduar çështjet e fundit institucionale për këtë projekt.
- Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës - Termali i pasagjerëve Tiranë dhe ndërtimi i linjës hekurudhore Tiranës – Rinas (kredi), është planifikuar në vlerën 316,500,080 lekë dhe është realizuar në masën 148%. Punimet kanë nisur në terren me aktivitetet e para.
- Hartimi i projektit të detajuar inxhinierik për Rehabilitimin e linjës hekurudhore Durrës-Rrogzhinë, është planifikuar në vlerën 24.200.000 lekë, i cili nuk është realizuar. Vazhdon disbursimi në varësi të faturimit të konsulentit pranë donatorëve të huaj. Konsulenti ka përfunduar 100% paketën e projektit të detajuar inxhinierik, studimin mjedisor social.
- Hartimi i projektit preliminar Rrogzhinë-Pogradec-Lin (kufi me Maqedoninë e Veriut), është planifikuar në vlerën 49,800,000 lekë, i cili nuk është realizuar. Pritet konsulenti për të nisur implementimin e hartimit të projektit.
- Shërbime të transportit të mallrave që lidhin operatorët shpërndares dhe transportues të mallrave/SCOPE, është planifikuar në vlerën 3,689,333 lekë dhe është realizuar në vlerën 2.250 lekë.

PROGRAMI “TRANSPORTI AJROR“

Ky program merret me hartimin e politikave zhvilluese të transportit ajror që synojnë përmirësimin e kuadrit ligjor dhe administrativ, në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare dhe për të mundësuar gjetjen e burime të ndryshme financuese dhe investuese për infrastrukturën aeroportuale, me qëllim krijimin e një tregu konkurrues në shërbimet ajrore.

Qëllimet e Politikës së Programit: Integrimi i aviacionit civil shqiptar në sistemet evropiane të transportit ajror në nivel administrativ dhe nivel tekniko-funksional.

Objektivat dhe produktet të cilat synohen të arrihen gjatë kësaj periudhe, përgjithësisht janë të lidhur me:

- ✓ zhvillimin dhe ndërtimin e infrastrukturave të reja aeroportuale, me qëllim krijimin e një tregu konkurrues me shërbime ajrore të liberalizuar
- ✓ rritjen e standarteve dhe performancës së Organit Kombëtar të incidenteve/Aksidenteve ajrore nëpërmjet investimeve për forcimin e kapaciteteve

Në këtë program buxhetor përfshihen shpenzimet për mbarëvajtjen e funksionimit të Organit Kombëtar të Incidenteve/Aksidenteve Ajrore si dhe kontrata për Shërbimet inxhinierike të pavarura për zbatimin e Kontratës Koncesionare/PPP “Për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e Aeroportit të Kukësit, për të cilën u realizuan 93.327.000 leke kundrejt 94.000.000 leke ose 99.3 %.

PROGRAMI “FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIME”

Spektori i Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime është bazuar në realizimin e objektivave të mëposhtme:

- Furnizimin me ujë të zonave urbane,
- Zgjerimin dhe përmirësimin e furnizimit me ujë të zonave bregdetare,
- Mbulimin e kostos operative dhe rritja e performancës së ndërmarrjeve,
- Mbulimin me kanalizime dhe ITUN.

Shpenzimet Korrente

Në këtë program buxhetor janë përfshirë shpenzime për funksionimin e administratës së Agjencisë Kombeëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve si dhe subvencioni për ndërmarrjet /sha. ujësjellës kanalizime.

Realizimi i shpenzimeve korrente sipas klasifikimit ekonomik, paraqitet si më poshtë:

-Fondi i pagave (art.600), plani vjetor i vitit 2021 prej 50,000 mijë lekë është realizuar në vlerën 44,442 mijë lekë ose në masën 89%.

-Fondi i sigurimeve shoqërore (art. 601), plani vjetor 2021 prej 8,500 mijë lekë është realizuar në vlerën 7,320 mijë lekë ose në masën 86%.

-Fondi i shpenzimeve operative (art.602), plani prej 26.988 mijë lekë është realizuar 24.666 mijë lekë, ose në masën 91%.

-Subvencioni (art.603), plani prej 380.000 mijë lekë është realizuar 358.272 mijë lekë, ose në masën 94%.

-Fondi për transport, buxhet familjar dhe individë (art.606), plani prej 226 mijë lekë është realizuar në vlerën 217 mijë lekë, ose 99 %.

Shpenzimet Kapitale me financim të brendshëm

Për artikullin 230 (studime, projektim dhe oponencë teknike) për vitin 2021 janë planifikuar 225.097 mijë lekë dhe janë financuar 224.597 mijë lekë, ose 100% të planit të akorduar.

Për artikullin 231 (investime me financim të brendshëm) ku përfshihet dhe TVSH + KL) për vitin 2021 janë planifikuar 13,223,919 mijë lekë dhe janë financuar 12,685,479 mijë lekë ose 96% e planit të akorduar.

Realizimi sipas produkteve

Investimet buxhetore për rezultatin A/I: Ujësjiellës i ri,

Për investimet në këtë kategori produktesh plani i rishikuar i vitit 2021 është në vlerën **8,807,543** mijë lekë .Në përfundim të periudhës raportuese është realizuar financimi në vlerën **8,540,917**mijë lekë ose 97% e planit të akorduar.

Investimet buxhetore për rezultatin A/II: Rikonstruksion Ujësjiellësi.

Për investimet në këtë kategori produktesh plani i rishikuar i vitit 2021 është në vlerën **2,833,707** mijë lekë .Në përfundim të periudhës raportuese është realizuar financimi në vlerën **2,744,860** mijë lekë, ose 97% e planit të akorduar.

Investimet buxhetore për rezultatin A/III: Kanalizimi i ri.

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit buxhetor të rishikuar të vitit 2021 janë planifikuar **857,447** mijë lekë. Në përfundim të periudhës raportuese është realizuar financimi **787,880**mijë lekë, ose 92 % e planit të akorduar.

Investimet buxhetore për rezultatin A/IV: Rikonstruksion KUZ.

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit buxhetor të rishikuar të vitit 2021 janë planifikuar **79,247**mijë lekë .Në përfundim të periudhës raportuese është realizuar financimi **78,915** mijë lekë, ose 100 % e planit të akorduar.

Investimet buxhetore për rezultatin A/V: I.T.U.P

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit buxhetor të rishikuar të vitit 2021 janë planifikuar **247,167** mijë lekë .Në përfundim të periudhës raportuese është realizuar financimi **176,130** mijë lekë, ose 71% e planit të akorduar.

Investimet buxhetore për rezultatin A/VI: Konsulencë

Për shërbim konsulence sipas planit buxhetor të rishikuar të vitit 2021 janë planifikuar **235,243** mijë lekë. Në përfundim të periudhës raportuese është realizuar financimi **234,657** mijë lekë, ose 100% e planit të akorduar.

Shpenzimet Kapitale me Financim të Huaj

Për artikullin 230 (konsulencë) për vitin 2021 janë planifikuar 50,000 mijë lekë dhe janë financuar 38,441 mijë lekë, ose 77 % e planit të akorduar.

Për artikullin 231 (investimej) për vitin 2021 janë planifikuar 2,977,306 mijë lekë dhe janë financuar 2,539,871 mijë lekë ose 85 % të planit të akorduar.

Realizimi sipas produkteve

Investimet me Financim të Huaj për rezultatin B/I: Ujësjellës I ri

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit të rishikuar të vitit 2021 janë planifikuar 1,436,962 mijë lekë .Në përfundim të periudhës raportuese janë realizuar 1,389,238 mijë lekë ose 97 % e planit të akorduar.

Investimet me Financim të Huaj për rezultatin B/II: Kanalizimi i ri

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit të rishikuar të vitit 2021 janë planifikuar 1,687,340 mijë lekë .Në përfundim të periudhës raportuese janë realizuar 1,413,356 mijë lekë ose 84 % e planit të akorduar.

Investimet me Financim të Huaj për rezultatin B/III: Impianti i Trajtimit të Ujrave të Zeza

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit të rishikuar të vitit 2021 nuk ka realizim.

Investimet me Financim të Huaj për rezultatin B/IV: Konsulencë

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit të rishikuar të vitit 2021 janë planifikuar 291,666 mijë lekë. Në përfundim të periudhës raportuese janë realizuar 122,435 mijë lekë ose 42% e planit të akorduar.

PROGRAMI “MENAXHIMI I MBETJEVE URBANE”

- Buxheti i shpenzimeve korrente, në vlerën 600,000,000 lekë është realizuar në vlerën prej 597,773,000 lekë ose 99,6 %, nga Bashkia Tiranë për projektin koncesionar “Për ndërtim Landfilli, inceneratori dhe rehabilitimin e venddepozitimeve ekzistuese në Tiranë”,
- Buxheti i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm, në vlerën 1,924,272,000 lekë është realizuar në vlerën 1,752,533,000 lekë, ose 91%.
- Buxheti i shpenzimeve kapitale me financim të huaj, në vlerën prej 899,000,000 lekë është realizuar në vlerën 873,795,000 leke ose 98%.

Plani i buxhetit për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm dhe me financim të huaj ka pësuar pakësime nga zbatimi i Aktit Normativ nr.34, datë 03.12.2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2021", ku:

- Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, janë pakësuar në vlerën 139,300,000 lekë,
- Shpenzimet kapitale me financim të huaj, janë pakësuar në vlerën 151,000,000 lekë,

Gjatë vitit 2021, ka vazhduar zbatimi dhe financimi i projekteve në fushën e infrastrukturës së mbetjeve urbane si:

- "Mbyllja dhe rehabilitimi i venddepozitimit ekzistues të mbetjeve të ngurta Eko Park Durrës"
- "Ndërtim i venddepozitimit Bushat, faza II"
- "Punime shtesë të impiantit të trajtimit të ujrave dhe shtresave të landfillit Bajkaj"

Ndërkohë që projekti për ndërtimin e "Stacionit të Transferimit për Bashkinë Himarë (Dhërmi)", me autoritet kontraktor Bashkinë Himarë, nuk ka patur realizim buxheti, pasi për këtë projekt nuk u zhvilluan procedurat e prokurimit.

Gjithashtu janë mbështetur me fonde buxhetore rimbursimi i TVSH dhe Kostos Lokale, për projektet me financim të huaj nga donatorët.

Në projektet me financim të huaj, gjatë vitit 2021, ka vazhduar zbatimi dhe financimi i projekteve ku plani për vitin 2021 prej 899,000,000 lekë është realizuar 873,795,000 lekë, ose në masën 97%, për projektet:

- "Sistemi i menaxhimit të mbetjeve të ngurta në Qarkun Vlorë" me fondet e disbursuara nga kredia dhe granti, realizimi financiar është në vlerën 603,789,000 lekë.
- "Sistemi i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta në Qarkun e Beratit", realizimi financiar është në vlerën 54,832,000 lekë.
- "Studim Fizibiliteti për zonat funksionale të Mbetjeve Elbasan dhe Fier", realizuar në vlerën 75,184,000 lekë.

PROGRAMI “MBËSHTETJE PËR ENERGINË”

Ky program buxhetor, përfshin fondet buxhetore në mbështetje të politikave për fushën e energjisë, si atë elektroenergjitike, energjisë së rinovueshme dhe eficientës për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Nëpërmjet këtij programi financohen institucionet si AKBN si dhe Agjencia e Eficencës së Energjisë si dhe kryen pagesat e TVSH-ve dhe Kostove Lokale për projektet me financim të huaj, bazuar në marrëveshjet përkatëse.

Duke qenë se sektori energjetik është konsideruar si një sektor i një rëndësie të veçantë, janë alokuar nga buxheti fonde për kryerjen në kohë të studimeve dhe oponencave të nevojshme në sektorin energjitik si dhe për krijimin e kushteve të favorshme me synim orientimin e profesionistëve dhe bizneseve drejt zbatimit të politikave për eficientën e energjisë në Shqipëri.

Shpenzimet korrente

Në shpenzimet korrente të këtij programi, janë përfshirë shpenzime personeli si dhe shpenzime operative për institucionet buxhetore Agjencia Kombëtare e Energjive Bërthamore (AKOB) dhe Agjencia e Eficencës së Energjisë (AEE) të cilat kanë si objektiv hartimin dhe implementimin e projekteve në fushën e energjisë si dhe monitorimin e projekteve në varësi të tyre duke nxitur diversifikimin e burimeve energjitike dhe për të promovuar uljen e konsumit të energjisë nëpërmjet realizimit të masave të eficientës, si dhe fondet për pagesat e avokatëve të kontraktuar për përfaqësimin dhe mbrojtjen e arbitrazhit ndërkombëtar kundër Republikës së Shqipërisë.

Fondet për shpenzimet korrente janë realizuar si më poshtë:

- Fondi për *paga*, planifikuar 17,100,000 lekë dhe realizimi financiar është 16,436,940 lekë, ose 96%.
- Fondi për *sigurime shoqërore*, planifikuar 3,800,000 lekë dhe realizimi financiar është 2,673,304 lekë, ose 70%.
- Fondi për *shpenzimet operative*, planifikuar 6,014,000 lekë dhe realizimi financiar është 3,055,599 lekë, ose 51%.
- Fondi për *transfertat buxhetore për familje e individë*, planifikuar 496,600 lekë dhe realizimi financiar 15,800 lekë, ose 3%.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm

Për realizimin e objektivave buxhetore të programit janë planifikuar dhe realizuar produktet si më poshtë vijon:

Produkti “*Monitorime në sektorin Energjetik*”, ka në përbërjen e tij 2 nënprodukte:

- Kontrolli i realizimit të investimeve për ndërtimin e HEC-ve me konçension sipas kontratave përkatëse dhe marrja në dorëzim e tyre, sipas programit të zhvillimit të projekteve të vlerësuar nga Oponenca Teknike - Raporte për Oponencën Teknike, është realizuar në masën 100%.
- Hartimi i bilancit energjetik bazuar në përpunimin e informacionit sipas standarteve dhe rregulloreve të statistikës së energjisë të BE-së - Bilanc Energjetik, është realizuar në masën 100%.

Produkti “*Studime për përmirësimin e sektorit energjetik, përmirësimin e efikasitetit të energjisë, zhvillimin e burimeve të rinovueshme*” ka në përbërjen e tij 14 nënprodukte (studime) të planifikuara për tu realizuar gjatë vitit 2021 nga të cilat janë realizuar plotësisht 13 prej tyre dhe 1 prej tyre në masën 97% si më poshtë vijon:

- Studimi për vlerësimin e efikasitetit të përdorimit të burimeve energjetike hidrokarbure në sektorin e transportit referuar zhvillimeve teknologjike (ishte Studimi mbi fuqizimin e infrastrukturës së furnizimit me burime energjetike me bazë hidrokarbure), është realizuar në masën 100%.
- Studimi mbi fuqizimin e infrastrukturës së furnizimit me burime energjetike me bazë hidrokarbure, është realizuar në masën 100%.
- Studim për vlerësimin e efikasitetit të përdorimit të burimeve energjetike hidrokarbure në transport referuar zhvillimeve teknologjike në këtë fushë, është realizuar në masën 100%.
- Projekt ide, studim fisibiliteti dhe projekt zbatimi i sistemit të ngrohjes së Korçës duke përjashtuar lenden drusore (projekt i ri), është realizuar në masën 100%.
- Hartimi i projektit të detajuar të sistemit të ngrohjes së Korçës duke përjashtuar lëndën drusore, është realizuar në masën 100%.

- Standardet e ndriçimit Urban dhe Rrugor në Republikën e Shqipërisë, është realizuar në masën 100%.
- Studimi i plotë i fisibilitetit për vendosjen e Kullave të Karikimit për makinat elektrike në Republikën e Shqipërisë, është realizuar në masën 100%.
- Projekt ide mbi elektrifikimin e linjave të transportit urban dhe ndërqytetas në Bashkitë Tiranë, Vlorë, Durrës (Me faza), është realizuar në masën 100%.
- Projekt për llogaritjen e kostos optimale për kushtet minimale në ndërtesa, është realizuar në masën 100%.
- Projekt faturimi informativ, Fushatat e ndërgjegjësimit, Edukimi dhe trajnimi për eficiencën e energjisë, është realizuar në masën 100%.
- Blerja e pajisjeve teknike të auditimit për procesin e mbikëqyrjes së CPE Projekt për standardet e ndriçimit rrugor dhe urban në Shqipëri, është realizuar në masën 100%.
- Studim mbi ndikimin në mjedis nga aktivitetit në sektorin hidrokarbur, është realizuar në masën 100%.
- Rregullore për Verifikimin e kriterëve të qëndrueshmërisë, normat teknike dhe procedurat për prodhimin dhe përzierjen e biokarburantet, është realizuar në masën 100%.
- Hartimi i projektit të detajuar për vendosjen e kullave të karikimit për makinat elektrike në Republikën e Shqipërisë, është realizuar në masën 97%.

Produkti *“TVSH + Kosto Lokale për projektet në fushën e energjisë”*, ka në përbërjen e tij 9 nënprodukte nga të cilat gjatë vitit 2021 janë realizuar plotësisht 4 prej tyre dhe pjesërisht 2 prej tyre, si më poshtë:

- TVSH - Rehabilitimi i Qytetit Studenti Nr. 2 - Ndërtesa të rehabilituara me masa eficiente është realizuar në masën 100%.
- TVSH për projektin "Rimëkëmbje e sektorit Energjetik", është realizuar në masën 100%.
- TVSH - Projekti "Mbështetja e sektorit të efijencës së energjisë dhe zhvillimi i burimeve të rinovueshme të energjisë", është realizuar në masën 100%.
- Kosto Lokale për projektet GAMES TARGE TBLEU DEAL SME.EC [Projekti ENERJ] dhe Re-Source, është realizuar në masën 100%.
- TVSH Projekti ENERJ bëhet TVSH për projektet GAMES TARGE TBLEU DEAL SME.EC dhe Re-Source, është realizuar në masën 95%.
- Kosto Lokale për projektin "Rimëkëmbje e sektorit Energjetik", është realizuar në masën 62%.

Produkti “Ndërtim/Rikonstrukcion”, ka në përbërjen e tij 6 nënprodukte gjatë vitit 2021 nga të cilat janë realizuar plotësisht 3 prej tyre dhe pjesërisht 2 prej tyre, si më poshtë:

- Projekt pilot për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në impiantet e furnizimit me ujë, është realizuar në masën 100%.
- Vendosja e sistemit të ndriçimit, parkimit, furnizimit elektrik të makinave "2km Smart City - rruga e Energjisë Pastër", është realizuar në masën 100%.
- Projekt pilot për sistemin e ndriçimit, parkimit, furnizimit elektrik të makinave "2km Smart City - rruga e Energjisë Pastër", është realizuar në masën 100%.
- Projekt Pilot për përmirësimin e Efikasitetit të Energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza, është realizuar në masën 97%.
- Supervizion i projekteve të zbatimit të projekteve më lartë, është realizuar në masën 54%.

Projektet në proces realizimi si më poshtë:

- Projekt pilot për ndërtimin e një godine me “0 Energji”,
- TVSH Projekti PRO – ENERGY,
- TVSH "Bashkëpunimi Greqi-Shqipëri për ndërtesat me konsum zero, (Greece Collaborates with Albania for nZEBs)".

Shpenzimet kapitale me financim të huaj

Mosrealizimi në kohë të projekteve sa më sipër ka ardhur si rezultat i disa faktorëve ku mund të evidentojmë vonesat në procesin e amendimit të Marreveshjes Financiare që kanë ndikuar dhe në praktikën e TVSH-së, si dhe pasojë e procesit të zgjatur të komunikimit me autoritetet menaxhuese të disa projekteve bazuar në kërkesat për ndryshimin e partnerit etj. Këto projekte edhe pse rezultojnë pa realizim konkret, janë në proces në përmbushje të kushteve të kontratës, brenda afateve kohore dhe vlerave financiare të përcaktuara në të.

PROGRAMI “MBËSHTETJE PËR BURIMET NATYRORE”

Për vitin 2021, objektivat e këtij programi buxhetor janë realizuar, në:

- Promovimin e burimeve të pashfrytëzuara të mineraleve të kromit, bakrit dhe ranor silicor, vlerësimi sasior dhe cilësor i rezervave minerare, hartimi i studimeve dhe projekteve gjeologjike, studimi dhe vlerësimi i pasurive natyrore të lëndëve hidroenergjetike. Vlerësimin e rrezeve gjeologjike mbi qëndrueshmërinë e truallit dhe infrastrukturës publike në shkallë vendi dhe vlerësime emergjente. Mirëadministrimi i territorit në shkallë vendi, nëpërmjet përpilimit të hartave gjeologjike, gjeomjedisore gjeomonumenteve.

- Shfrytëzimin me efikasitet të burimeve natyrore minerare nga shoqëritë e licensuara për këtë veprimtari nëpërmjet zbatimit të kushteve tekniko - profesionale dhe mjedisore sipas standarteve europiane.
- Rritjen e transparencës në industrinë nxjerrëse, me qëllim rritjen e cilësisë në mirëqeverisjen e industrisë nxjerrëse.

Shpenzimet korrente

Në këtë program buxhetor përfshihen shpenzimet për mbarëvajtjen e funksionimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.

- Fondi për pagat dhe sigurimet shoqërore (art.600 dhe 601) në vlerën 119,014,000 lekë, është realizuar në vlerën 118,146,000 lekë, ose 99%.
- Fondi për shpenzimet operative (art.602) në vlerën 18,334,000 lekë, është realizuar në vlerën 18,115,000 lekë, ose 99%.
- Fondi për transfertat korrente të huaja dhe transfertat buxhetore për familje të individëve (art.605 dhe 606) është planifikuar në vlerën 1,302,000 lekë dhe realizimi financiar është 1,204,000 lekë, ose 93%.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm

Në projektet me financim të brendshëm, janë zbatuar projekte studimore në fushën minerare, të monitorimit të subjekteve minerare të licensuar në fushën e shfrytëzimit mineral, studimeve gjeologjike, gjeofizike, hidrologjike, të cilat janë implementuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, dhe ndërmarrjet në likuidim Albakër sh.a, Albkrom sh.a, Albinierat sh.a.

Objektivat e këtij programi janë realizuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, e cila për vitin 2021, ka realizuar zbatimin dhe financimin e 7 projekteve studimore, në vlerën 45,100,000 lekë, me një realizim financiar prej 45,100,000 lekë ose 100% e planit të realizuar, në projektet si vijon :

- Projekti "Përditësim gjeohapsinor i të dhënave të lejeve minerare"
- Projekti "Azhornimi gjeohapsinor i hapësirave që krijohen nga shfrytëzimi mineral nëntokësor"
- Projekti "Mbikqyrja e shfrytëzimit të burimeve minerare metalore dhe jometallore"
- Projekti "Promovimi i mineraleve të rinj dhe kërkimet teknologjike të mjedisore"
- Projekti "Studim mbi zonimin mineral dhe hartimi i planit vjetor dhe 3-vjeçar mineral"
- Projekti "Raport vjetor mbi gjëndjen mjedisore në industrinë minerare dhe metalurgji"
- Projekti "Monitorimi i fenomeneve të postshfrytëzimit në minierat e mbyllura"

Për ndërmarrjet në likuidim "Albiniera", "Albkrom", "Albakër" sh.a, plani i buxhetit për vitin 2021, në vlerën 44,900,000 lekë është realizuar 44,900,000 lekë ose 100% e planit, ku janë likuiduar detyrimet e prapambetura për pagat, sigurimet shoqërore të punonjësve, detyrime tatimore dhe ndaj të tretëve, si më poshtë:

- Shoqëria Albiniera, plani 23,000,000 lekë, realizimi financiar 100%

- Shoqëria Albakër, plani 7,500,000 lekë, realizimi financiar 100%
- Shoqëria Albkrom, plani 14,400,000 lekë, realizimi financiar 100%

Për Sekretariatit Teknik Shtetëror, fondet e planifikuara në vitin 2021, për projektin "Raport mbi industrinë nxjerrëse në Shqipëri", në vlerën 15,000,000 lekë, realizimi financiar në vlerën 8,602,000 lekë ose 58 % e realizuar.

Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, projekti "Aparatura e paisje teknologjike, paisje pune profesionale për nevoja të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar", në vlerën 20,000,000 lekë është lidhur kontrata dhe është realizuar financimi deri në fund të vitit 2021, në masën 100%.

PROGRAMI “MBËSHTETJE PËR INDUSTRIJË”

Qëllimi i programit: Rritja e nivelit të sigurisë së shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe përdorimit të produkteve/pajisjeve/instalimeve në fushat e veprimtarisë së MIE; Reduktimi i aksidenteve në punë; eliminimi i rrezikut të dëmtimit të shëndetit të njerëzve dhe mjedisit nga kimikatet e rrezikshme të papërdorshme gjendje në kushte të pa sigurta depozitimi dhe ruajtje në magazinat apo ambientet e ish ndërmarjeve dhe subjekteve publike në varësi të MIE, në dy landfillet në të cilat janë depozituar mbetjet e rrezikshme nën administrimin e MIE dhe në QGTK; Likuidim dhe mbyllje e ish ndërmarjeve industriale në varësi të MIE duke realizuar transferimin e plotë të aseteve të mbetura nga administrim shtetëror në administrim privat. Nxitja e interesit të biznesit, për mundësi zhvillimi veprimtari industriale. Rritjen e shkallës së përpunimit në vend i burimeve natyrore me synim rritjen e kontributit në GDP, eksport dhe punësim. Për vitin 2021, objektivat e këtij programi buxhetor janë:

- Zhvillimi i strukturave dhe burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për inspekimin dhe mbikqyrjen, sigurinë në punë dhe për ndërhyrjet e shpëtimit në raste avarish, për monitorimin e inspektimit dhe mbikqyrjes së sigurisë teknike të produkteve/pajisjeve/instalimeve në fushat e veprimtarisë së MIE dhe emergjencat civile.
- Sigurimi i kushteve të domosdoshme për inspekimin dhe mbikqyrjen e shëndetit, sigurisë në punë, emergjencat dhe shpëtimin në veprimtarinë minerare dhe në punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike.
- Rritja dhe përmirësimi i standarteve, kushteve të punës dhe të sigurisë së depozitimit dhe ruajtjes së kimikateve të rrezikshme në Qendrën e Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme.
- Sigurimi i kushteve për administrimin e dy landfillet në të cilat janë depozituar mbetjet e rrezikshme nën administrimin e MIE.
- Konservimi, likuidimi dhe mbyllja e ish ndërmarjeve industriale në varësi të MIE.
- Promovimi tek biznesi i studimeve tekniko-ekonomike për industrinë e lëkurë këpucës, industrisë së bakrit, nikel silikateve dhe kuarciteve si dhe i disa ish territoreve industriale për ushtrimin e veprimtarive ekonomike.

Për realizimin e këtyre objektivave, financohen institucionet si Agjensia Kombëtare për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera (AKSEM), Inspektoriatit Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), Qendra e Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme (QGTKRR) Elbasan dhe ndërmarjet në konservim si Ndërmarrja Azotikut Fier, Ndërmarrja e Prodhim Çelikut Elbasan, Kombinati Energjistik Elbasan.

Ky program buxhetor, përgjithësisht përfshin fondet buxhetore në mbështetje të politikave për zhvillimin e industrisë. Fondet e alokuara për këtë program buxhetor të shpenzimeve totale të miratuara për MIE-n për vitin 2021 janë 406,854 mijë lekë. Ndërkohë, referuar të dhënave mbi shpenzimet faktike, rezulton se gjatë 4muajorit të dytë të vitit 2021 shpenzimet për këtë program janë realizuar në masën 60 %.

Realizimi i buxhetit për vitin 2021 në nivel produkti, është si më poshtë:

Shpenzimet Korrente

- Produkti “Shpenzime për paga”, është realizuar në masën 98%.
- Produkti “Sigurime Shoqërore”, është realizuar në masën 97%.
- Produkti “Shpenzime Operative” është realizuar në masën 99%.
- Produkti “Transferata” është realizuar në masën 48%.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm

- Produkti “Pajisje dhe aparatura për grupin shpëtim inspektimit” është realizuar në shumën 1,975 mijë lekë ose 100% e planit.
- Produkti “Monitorim landfilli Azotiku” është realizuar në shumën 945 mijë lekë ose 94% e planit.
- Produkti “Blerje paisje kompjuterike dhe sigurim me kamera” është realizuar në shumën 1,269 mijë lekë ose 92% e planit.
- Produkti “Hapje pusi për furnizim me ujë ” është realizuar në shumën 594 mijë lekë ose 100% e planit.
- Produkti “Konservim Kombinati Energetik Elbasan” është realizuar 100%
- Produkti “Konservim Ndermarrja e Prodhim Çeliku Elbasan” është realizuar 100%.
- Produkti “Konservim Azotiku Fier” është realizuar 94%,
- Produkti “Aparatura Laboratorike për treguesit cilësor të naftës dhe gazit, nuk u realizua pasi u pakësuan fondet me Aktin normativ nr 34 dt. 03.12.2021.
- Produkti “Blerje mjet transporti per inspektim dhe emergjenca” nuk u realizua per shkak te proceduraver të prokurimit nga Ministria Brendshme.

PROGRAMI “MBËSHTETJE PËR RRJETET E KOMUNIKACIONIT”

Në programin “Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit”, nuk janë parashikuar shpenzime korrente dhe shpenzime kapitale me financim të brendshëm dhe për këtë arsye janë kërkuar fonde shtesë për shpenzime kapitale me financim të brendshëm dhe shpenzime kapitale me financim të huaj.

Projekte të parashikuara për vitin 2021:

- Projekt pilot, Asistencë teknike për zhvillimin e Broadband-it në zonat rurale (Shkodër, Kukës, Tropojë, Dibër-pjesë e programit “100 villages”), grant me vlerë 700.000 Euro, në kuadër të WBIF-23.

Ky projekt ka filluar në datë 15.10.2021 dhe deri tani ka përfunduar faza e parë e “Inception report” e cila u prezantua në takimin e zhvilluar në datë 16.12.2021.

- Projekti “Zhvillimit Rajonal i Broadband - Asistencë teknike - Projekti i Atlasit të Bradband”, grant me vlerë 250.000 Euro.

Projekti nuk filloi sipas parashikimeve brenda vitit 2021 dhe takimi i parë u zhvillua më 17.02.2022.

PROGRAMI “PLANIFIKIMI URBAN”

Ky program harton, mbështet dhe zbaton procese dhe politika për planifikimin. Ka për qëllim ndër të tjera të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit; të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillimin e territorit në nivel kombëtar, rajonal e vendor; të mundësojë të drejtën e përdorimit e të zhvillimit të pronës; të krijojë kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta, të sigurojë që autoritetet kombëtare e vendore të planifikimit të hartojnë e të përditësojnë rregullisht dokumentet e planifikimit.

Politikat e këtij programi synojnë:

- Planifikim dhe zhvillim të qëndrueshëm të territorit në çdo nivel dhe në bashkërendim me çdo sektor;
- Rigjenerimin urban dhe krijimin e modeleve të reja të zhvillimit të territorit;
- Mundëson kushte të përshtatshme për stafin i cili merret me çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
- Përmirëson kuadrin ligjor në fushën e projektimit;

Qëllimi i politikës së këtij programi është:

- Zhvillimi i qëndrueshëm dhe i balancuar i territorit, garantimin e ekuilibrit midis interesave publikë dhe privatë, në zhvillimin e territorit;
- Kryerja e procesit mbi rikualifikimin urban të zonave përmes projektsh pilot, urbanizimi dhe integrimi;
- Hartimin e rregullave dhe standarteve të projektimit në fushat e projektimit të universiteteve dhe ambientet ndihmëse të tyre;

Objektivat e politikës së programit janë:

1. Mbikëqyrja e procesit të hartimit dhe mbështetja teknike për hartimin e planeve të përgjithshme vendore në 16 bashki të vendit, koordinimi i procesit me grupet e interesit dhe publikun, duke i harmonizuar këto plane me PPK, PINS Durana dhe PINS Tiranë Durrës. Krijimi i një mjedisi institucional, ekonomik e social për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet transparencës në planifikimin dhe zhvillimin e territorit, si dhe në proceset ligjore që rregullojnë planifikimin dhe zhvillimin. Planet e Përgjithshme Vendore kanë për qëllim të sigurojnë një zhvillim ekonomik dhe shoqëror, të shpërndarë në mënyrë të barabartë në të gjithë bashkinë.
2. Mbështetës në projekte, të cilat kanë fokus zhvillimin rajonal. Vlerësim dhe analizë të gjendjes ekzistuese të territorit, vlerësim të potencialeve, risqeve dhe mundësive që paraqet territori për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor.

3. Projekti mbështetëse për ripërtëritjen urbane, për të stimuluar sipërmarrjet mikro dhe të vogla me potencial të madh tek burimet lokale, rijetësimi i infrastrukturës pritëse dhe i infrastrukturës përcjellëse tek zonat e interesit në ndihmë të zhvillimit të sipërmarrjes, drejtuar nga nevojat për zhvillim, për t'u përdorur si projekt pilot.
4. Krijimin e sistemeve për hartimin dhe përdorimin e manualeve në ndërtim, me qëllim që ky shërbim të ofrohet për të gjitha autoritetet përdoruese dhe profesionistët e lirë.

Shpenzimet korrente (sipas klasifikimit ekonomik) realizimi rezulton:

	<i>në mijë lekë</i>
1. Shpenzimet për paga	16 090
2. Shpenzimet për sigurimet shoqërore	2 653
3. Mallra dhe shpenzime të tjera	8 575
4. Transferta për buxhetin familjar & individual	40

Shpenzimet kapitale

Në kete program janë parashikuar në total 103 milion lekë, 6.5 milionë për AQTN-në, dhe 96.5 milionë për projektet që ndjek Aparati i MIE.

Zbatimi i projekteve për vitin 2021:

- Projekti “Hartimi i Planeve të Përgjithshme Vendore”, për vitin 2021 është realizuar me një financim prej 39,812 mijë lekë ose në masën 100%.
- Projekti “Paisje informatike”, për vitin 2021 është realizuar me një financim prej 4,513 mijë lekë ose në masën 90.2%.
- Projekti “Pajisje mobilje zyre”, për vitin 2021 është realizuar me një financim prej 1,543 mijë lekë ose në masën 100%.
- Projekti “Hartimi i udhëzimeve për zbatimin e eurokodeve”, për vitin 2021 është realizuar me një financim prej 9,533 mijë lekë ose në masën 100%.
- Projekti “Shpronësime”, për vitin 2021 është realizuar me një financim prej 28,685 mijë lekë ose në masën 66%. Vlera nuk është shfrytëzuar plotësisht për shkak të mungesës së dokumentacionit të pronarëve, të cilët do të shpronsohen si pjesë e VKM nr. 504, datë 25.08.2021.
- Projekti “Hartimi i Anekseve Kombetare të Eurokodeve”, për vitin 2021 është realizuar me një financim prej 1867 mijë lekë ose në masën 97%.
- Projekti “TVSH –Projekti Zhvillimi Integruar dhe Qëndrueshëm të Zonave Bregdetare GIZ”, nuk është realizuar për vitin 2021. Ky projekt ka përfunduar në vitin 2018 dhe MIE duhet të bënte likuidimin e TVSH, sipas marrëveshjes. Fondet u planifikuan në vitin 2021 dhe për këtë Grupi i Punës në muajin Shtator realizoi procedurën për vijimin e likuidimit, të cilën e depozitoi pranë Sektorit të Financës.